



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 26.05.2023

Nr: 148

Ora: 10:30

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 82, DATË 23.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA  
KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Franci Nuri

**PALË E INTERESUAR:** Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z.  
Maringlen Legisi



**OBJEKT:**

1. Kundërshtim i vendimit nr. 292, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 20, bashkia Krujë, qarku Durrës “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Krujë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”.

2. Kundërshtim i vendimit nr. 293, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 20, bashkia Krujë, qarku Durrës “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Krujë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”.

3. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në ato QV të zonës zgjedhore bashkia Krujë, ku janë përfshirë komisionerë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Kodit Zgjedhor, si më poshtë vijon: Qv 1302/1; Qv 1298, Qv 1298/1, Qv 1299, Qv 1299/1, Qv 1302 (Nj. Administrative Fushë- Kruje) Qv 1285, Qv 1285/1, Qv 1285/2, Qv 1283, Qv 1289, Qv 1290, Qv 1288, Qv 1287, Qv 1286, Qv 1286/1, Qv 1282, Qv 1282/1 (Nj. Administrative Nikel): Qv 1267, Qv 1271 (Krujë); Qv 1257, Qv 1258, Qv 1255, Qv 1264 (Nj. Administrative Cudhi); Qv 1248, Qv 1251, Qv 1252, Qv 1254 (Nj. Administrative Bubq); Qv 1315, Qv 1316, Qv 1309, Qv 1319, Qv 1318/1, Qv 1311, Qv 1310/1, Qv 1321 (Nj. Administrative Thumanë).

4. Rregullimin e pasojave duke proceduar me ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit përkatës, duke mospërfshirë rezultatin e qendrave të votimit objekt ankimi.

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 123/1 dhe pika 2 e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan dhe miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve për kryetarët e bashkive dhe për këshill bashkiak. KZAZ nr. 20, bashkia Krujë ka miratuar vendimin nr. 292, datë 18.05.2023, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Krujë”, si dhe vendimin nr. 293, datë 18.05.2023, “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Krujë”.
2. Kundër këtyre vendimeve të KZAZ nr. 20, bashkia Krujë ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Franci Nuri, i cili ka kërkuar kundërshtimin e vendimeve, si më lart cituar, si dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në ato QV të zonës zgjedhore bashkia Krujë, ku janë përfshirë komisionerë në kundërshtim më përcaktimet ligjore të Kodit Zgjedhor. Në kërkesën e tij ankimore kërkon dhe rregullimin e pasojave, duke proceduar me ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit përkatës, duke mospërfshirë rezultatin e qendrave të votimit objekt ankimi.
3. Kërkesa ankimore nr. 82, e depozituar në KQZ më datë 23.05.2023 iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim, me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit më datë 26.05.2023, ora 10:30. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, përfaqësuesi i palës ankimuese, z. Franci Nuri, si dhe përfaqësuesi i palës së interesuar, z. Maringlen Legisi.
4. Përfaqësuesi në seancë i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Franci Nuri pretendoi se ka konstatuar parregullsi në të procesit zgjedhor në disa QV të bashkisë Krujë, në përputhje me pikën 2, të nenit 39 të Kodit Zgjedhor. Sipas z. Nuri, në disa QV janë të emëruar si anëtarë të komisioneve të KQV-ve, disa persona në konflikt interesi me kandidatin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste”, për shkak se janë në marrëdhënie pune më këtë kandidat. Ai u shpreh se ditën e zgjedhjeve, ka marrë indicie dhe ka prova për vëzhgues/komisionerë të “Partisë Socialiste” mbi shoqërimin e votuesve nga jashtë QV deri në kutitë e votimit, pa pasur autorizimin e posaçëm. Këto shkelje, sipas ankimuesit kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.



5. Përfaqësuesi në seancë i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Maringlen Legisi, kërkoi rrëzimin e kësaj kërkesë ankimore, si të pabazuar në ligj e në prova.
6. Gjatë seancës së shqyrtimit, z. Franci Nuri depozitoi kërkesën që ka bërë pranë KQZ-së, duke kërkuar marrjen e pamjeve filmike në QV e caktuara në objekt ankimi. Gjithashtu, z. Nuri kërkoi nga KAS, shtyrjen e seancës së shqyrtimit, për të marrë dhe kontrolluar materialet filmike. Kjo kërkesë, me shumicë votash u rrëzua nga KAS.
7. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - Kërkesën ankimore nr. 82, datë 23.05.2023;
  - Vendimin nr. 292, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 20 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Krujë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”;
  - Vendimin nr. 293, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 20 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Krujë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”;
  - Librin e Protokollit;
  - Kërkesën nr. 5546 prot., datë 26.05.2023 për saktësim objekti të kërkesës ankimore nr. 82, datë 23.05.2023.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstaton:**

1. Procedura e votimit dhe ajo e numërimit të votave janë procedura transparente dhe të dokumentuara në çdo hap. Kodi Zgjedhor është kujdesur që ato të zhvillohen në sytë e përfaqësuesve të subjekteve, vëzhguesve të pavarur dhe të publikut, si dhe çdo problem, parregullsi apo shkelje e ligjit të dokumentohet në procesverbalet tip dhe librat e protokollit të komisioneve përkatëse, si dhe të filmohet nga kamerat mbikëqyrëse të procesit, me qëllim që të shërbejë si provë materiale në proceset eventuale për kundërshtimin e rezultatit apo të zgjedhjeve në tërësi.

2. Dokumentacioni që prodhohet nga administrata zgjedhore gjatë zbatimit të procedurave të votimit dhe të numërimit të votave bën pjesë në radhën e parë dhe kryesore të provave ku mund të mbështeten kërkesat ankimore me objekt ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Subjektet zgjedhore kanë akses mbi këtë dokumentacion, në disa raste disponojnë ipso lege kopje të tij. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor u njuh palëve edhe të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në për marrjen e provave “për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre”.
3. Pika 1, e nenit 82 të K.Pr.A saktëson: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”*. Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 136, kur u kërkon palëve *“të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”*.
4. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t’i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Kjo do të thotë, se Kodi kërkon që raporti midis pretendimit dhe provës të jetë i drejtpërdrejtë, thënë ndryshe, prova duhet të shërbejë për të mbështetur drejtpërdrejt pretendimin. Pika 4 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor saktëson, se *“KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara”*. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.
5. Pretendimi themelor i ankuesit është se në administrimin e zgjedhjeve kanë marrë pjesë në cilësinë e komisionerit ose të numëruesit, persona të emëruar në kundërshtim me nenin 39, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Ankuesi sjell në mbështetje të këtij pretendimi tre shembuj, nga të cilët vetëm njëri referohet si punonjës i bashkisë Krujë, në lidhje varësie me kandidatin e “Partisë Socialiste” për kryetar bashkie në këtë zonë zgjedhore. Ankuesi nuk ka depozituar dokumentacion provues

për këtë pretendim, por gjithsesi e ka shfrytëzuar atë për të kërkuar pavlefshmëri zgjedhesh në qendrat e votimit objekt ankimimi.

6. Kushtet e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të komisionerit apo të numëruesit i vendosin personat në konflikt interesi me detyrën dhe formojnë shkak për shkarkimin e tyre, si anëtarë të komisioneve apo si numërues. Sipas pohimeve të ankuesit në procedurën e kushtetimit të komisioneve dhe të funksionimit të tyre para ditës së zgjedhjeve, si dhe në ditën e zgjedhjeve, nuk ka patur asnjë konstestim në këtë zonë zgjedhore bazuar në shkakun ligjor të papajtueshmërisë. Ankimimi paszgjedhor, saktësisht kërkesa për pavlefshmëri për shkak të ushtrimit të funksioneve në kushtet e papajtueshmërisë kërkon një natyrë tjetër prove, provën se administratorët zgjedhorë që kanë vepruar në konflikt interesi me vendimmarrjen e tyre të kenë ndikuar në prishjen ose cënimin e zgjedhjeve *“në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore”*. Provat për këtë mund të gjenden në Librat e Protokollit të komisioneve përkatëse dhe në arsyetimin e vendimmarrjes së komisioneve. Ankuesi nuk paraqiti në KAS asnjë provë të kësaj natyre në mbështetje të pretendimit të tij.
7. Ankuesi kërkoj nga Kas-i, që t'i vihej në dispozicionin pamje video nga kamerat e qendrave të votimit, me qëllim që të identifikonte nëpërmjet tyre identitete komisionerësh që mund të ishin eventualisht në kushte papajtueshmërie dhe veprime komisionerësh që mund të formonin eventualisht shkelje të ligjit. Kjo mënyrë formulimi e kërkesës është provë e faktit që gjithë kërkesa ankimore është ngritur pa u bazuar në prova dhe se provat po kërkoheshin të qëmtoheshin në shërbim të pretendimit. Kjo kërkesë është në kundërshtim flagrant me rregullat dhe procedurat si për marrjen dhe administrimin e proves, ashtu edhe për ngritjen e ankimit.
8. Si përfundim KAS konstatoi se kërkesa ankimore është e zhveshur nga provat dhe për pasojë pretendimet nuk mund të pranohen.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “c” dhe 143, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

## V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 82, datë 23.05.2023, të depozituar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Lënien në fuqi të vendimeve nr. 292 dhe nr. 293, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 20, bashkia Krujë.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 26.05.2023.

**Elvis ÇEFA - Relator (Kundër)**

**Elvin LAKO - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar (Kundër)**

## MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 82 të subjektit zgjedhor koalicioni Bashkë Fitojmë me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 292 dhe vendimit nr. 293, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 20, bashkia Krujë, qarku Durrës “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Krujë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në 36 QV të zonës zgjedhore bashkia Krujë. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit përkatës.”, ne anëtarët në pakicë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e ankimit në fjalë, ndaj paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim:

1. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se KAS nuk ka arritur në një konkluzion të drejtë në vendimmarrjen e ndërmjetme në lidhje me mospranimin e kërkesës së subjektit ankimues për t’i dhënë atij një kohë të arsyeshme për njohjen me informacionet dhe provat shtesë, njohje e cila do të kryhej nëpërmjet pamjeve video të qendrave të votimit, pamje që administrohen nga KQZ.
2. Qëndrimi i shumicës së anëtarëve të KAS, që të refuzojë marrjen e informacioneve apo provave të kërkuara nga ankimuesi është në fakt në kundërshtim me parashikimet e nenit 137 të Kodit Zgjedhor, por edhe të nenit 223 të Kodit të Procedurës Civile për provën. Ky qëndrim bie ndesh me parimet e hetimit administrativ e më konkretisht me nenit 77 të K.Pr.Administrative që parashikon se *“1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes. 3. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t’i kërkojë palës vetëm elementet e nevojshme për identifikimin e tyre”* apo *mutatis mutandis* (meqenëse KAS është quasi gjykatë për shqyrtimin administrativ të kërkesave ankimore në fushën e zgjedhjeve) me nenin 14



të K.Pr.Civile që parashikon se *“Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin”*.

3. Administrimi i provave është i një rëndësie të veçantë për një hetim të gjithanshëm të kërkesës ankimore, aq më tepër kur kërkesa bazohet në pretendime që hedhin dyshime për ekzistencën e një konflikti të hapur interesi të administratës zgjedhore në raport me njërin prej kandidatëve për kryetar bashkie apo në pretendimin se persona me rekorde kriminale kanë ndërhyrë në ambientet e qendrave të votimit, do duhej të bëhej një analizë më e plotë e të gjithë elementeve që mund të kenë ndikuar në formësimin e vullnetit të zgjedhësve apo pengimin e tyre për të votuar. Moslejimi i një hetimi të gjithanshëm, nuk ndihmon aspak në bërjen e transparencës të procesit zgjedhor.
  
4. Ideja e drejtësisë zgjedhore duhet të respektohet gjatë gjithë kohës kur përcaktohet se cila palë ka barrën për të provuar një fakt ose pretendim specifik dhe si paraqiten provat gjatë shqyrtimit administrativ. Për shkak të natyrës komplekse dhe politike të çështjeve të lidhura me proceset zgjedhore, procesi me të cilin barra e provës u ndahet palëve duhet të përcaktohet qartë paraprakisht kur paraqiten çështjet dhe shpërndarja e barrës midis palëve duhet të jetë e drejtë, pa ngarkuar njërin palë të mbajë të gjithë peshën e provës kur një çështje paraqitet për shqyrtim administrativ.
  
5. Si rregull kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen me provën që vërteton se shkelja e pretenduar është *“shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”* dhe çështja e provueshmërisë së këtyre shkeljeve ligjore të pretenduara nga ankimesit është e një rëndësie themelore, në mënyrë që KAS të dalë me një vendim të drejtë lidhur me objektin e ankimit. Por, përpara se të arrihet në konkluzionin që shkeljet e evidentuara nuk formojnë *“shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor”*, apo që këto shkelje nuk mund të provohet se kanë ndodhur ose që kanë pasur ndikim mbi zgjedhësit për tjetërsimin e votës, fillimisht duhet të ndalemi në analizën e faktit nëse ankimesi kishte mundësi objektive, në kushtet aktuale, që të siguronte provat në mënyrën e duhur. Edhe kjo analizë gjithashtu nuk mund të bëhet kurrësi duke mos i lejuar ankuesit të marrë një kohë të arsyeshme për t’u pajisur dhe për të vlerësuar pamjet video të qendrave të votimit ku ai pretendon

se ka pasur shkelje serioze të Kodit Zgjedhor në funksion të përpunimit dhe evidentimit të provave të pretenduara.

6. Është fakt i ditur botërisht se ankuesi e ka të pamundur për të aksesuar apo siguruar prova konkrete brenda afatit 5 ditor për depozitimin e kërkesave ankimore. Duhet pasur gjithashtu në konsideratë fakti se provimi me dokumentacion zyrtar i ngjarjeve të tilla nga ana e ankimuesit, është një proces pothuajse i pamundur për sa kohë subjektet politike nuk janë “ente shtetërore” të veshura me autoritet shtetëror që të mund të dokumentojnë (nëpërmjet mbajtjes së procesverbaleve të konstatimit etj.) apo të prodhojnë akte, që të mund të shërbejnë në një moment të dytë si provë shkresore të kryerjes së një veprimi të kundërligjshëm. Pikërisht kjo është arsyeja që ankimuesi koalicioni Bashkë Fitojmë, në këtë rast është në pamundësi objektive të sigurimit të provës në mënyrën e kërkuar.
7. Nenet 124 – 144 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë procedurën që ndjek Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve për shqyrtimin e një ankimi administrativ. Neni 136 pika 1 shkronja “c” i K.Zgjedhor parashikon se palët kanë të drejtë të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre. Për ne anëtarët e pakicës, qëndrimi i KAS duke refuzuar një kërkesë krejtësisht të arsyeshme ka sjellë si pasojë një vendimmarrje që nuk pasqyron produktin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të asaj se çka subjekti ankimues pretendoi gjatë shqyrtimit administrativ. Në këtë mënyrë shumica e anëtarëve të KAS anashkalon krejtësisht në mënyrë të pajustificuar tërësinë e elementëve/fenomeneve (të cilat ankuesit i konsiderojnë si shkelje flagrante të ligjit) të cilat mund të kenë ose kanë ndikuar drejtpërdrejt në deformimin e vullnetit të zgjedhësve gjatë procesit të votimit.
8. Në nenin 160 të K.Zgjedhor, parashikohen edhe rastet e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Në mënyrë që të analizohet në themel kjo dispozitë dhe të interpretohet në kuptimin qëllimor të saj, kërkohet një hetim i gjithanshëm mbi prova dhe një interpretim i Kodit Zgjedhor dhe i ligjit në përgjithësi (pasi neni 160 nuk kufizohet vetëm në shkelje të K.Zgjedhor), për të arritur në përfundimin nëse kemi të bëjmë me shkelje të tilla që pasjellin pavlefshmëri të zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi.

9. Potencialisht fenomenet e pretenduar si parregullsi nga ankimuesi, të analizuara si raste të izoluara, mund të mos përbëjnë në dukje shkak ligjor për të pasjellë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë të caktuar, por nëse e vlerësojmë këtë dukuri në këndvështrim të harmonizimit të të gjithë elementëve të kundërligjshëm të koordinuar paraprakisht, atëherë potencialisht ekziston një dyshim i arsyeshëm që graviteti i veprimtarisë së kundërligjshme të mund të ketë ndikuar në një mënyrë dhe masë të tillë në vullnetin e zgjedhësve sa që të mund të sjellë si pasojë pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Për sa kohë KAS nuk është në gjendje të verifikojë apo të konstatojë përmasën e këtyre “parregullsive procedurale”, atëherë afërmendsh që është në pamundësi të konkludojë drejtë nëse këto shkelje formojnë ose jo parregullsi ligjore të tilla që të mund të sjellin pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

10. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se për sa kohë hetimi administrativ që kufizon marrjen e provave ku palët bazojnë pretendimet e tyre, nuk u jep një përgjigje shteruese pyetjeve të përmendura më lart, vendimi i marrë me shumicën e votave të anëtarëve të KAS për rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 82 të subjektit zgjedhor koalicioni Bashkë Fitojmë është një vendim i pabazuar në prova e në ligj.

**Elvis ÇEFA** - Anëtar

**Ledio BRAHO** - Anëtar